



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEKANATI

Nr. 1080 Prot

Tiranë, më 26 . 10 . 2023

VENDIM

Nr. 80 datë 26/10/2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E GRUPEVE MËSIMORE-KËRKIMORE DHE KËRKIMORE-MËSIMORE NË
FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA TË UT-SË

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49 pika 6 në Statutin e UT-së, Dekanati i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në mbledhjen e datës 26.10.2023:

VENDOSI:

1. Të miratojë:

- Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Mësimore-Kërkimore dhe Kërkimore-Mësimore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të UT-së.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKAN

Prof.Dr. Esméralda KROMIDHA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E GRUPEVE MËSIMORE-
KËRKIMORE DHE KËRKIMORE-MËSIMORE
NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA TË UT-SË**



Miratuar me Vendimin e Dekanatit nr. 80, datë 26. 10. 2023

TIRANË

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton kuadrin e brendshëm rregullues të organizimit dhe funksionimit të grupeve mësimore-kërkimore dhe kërkimore-mësimore dhe marrëdhëniet e tyre me njësinë bazë.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë që organizimi dhe funksionimi i grupeve mësimorekërkimore dhe grupeve kërkimore-mësimore të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe në zbatim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25, pika 5; VKM nr.243, datë 20.4.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, lidhja 1, pika 9, 10: Udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017 të MASR “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 8; Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 të MASR “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, pika 6, 7; Statutit të Universitetit të Tiranës, miratuar me Urdhërin nr.816, datë 26.12.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, neni 14, 19, 51.

Neni 4

Fusha e veprimit



Kjo rregullore zbatohet nga njësitë bazë, strukturat administrative dhe dekanati i FGJH.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GRUPEVE MËSIMORE-KËRKIMORE DHE GRUPEVE KËRKIMORE-MËSIMORE

Neni 5

Parime për krijimin, riorganizimin dhe mbylljen

1. Në FGJH mund të krijohen grupe mësimore-kërkimore dhe grupe kërkimore-mësimore të përhershme ose të përkohshme, si struktura të njësisive bazë ose të bashkëpunimit të dy ose më shumë njësisive bazë.
2. Grupi mësimor- kërkimor dhe grupi kërkimor-mësimor është një strukturë që ka përgjegjësi zhvilluese për aspekte të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore brenda një departamenti a qendre ose dy ose më shumë njësisive bazë të FGJH.
3. Krijimi i grupeve mësimore-kërkimore dhe grupeve kërkimore-mësimore, riorganizimi ose mbyllja e tyre bëhet në bazë të strategjisë së zhvillimit të FGJH dhe sipas kriterëve të përcaktuara nga dekanati i FGJH.
4. Grupet mësimore-kërkimore dhe grupet kërkimore-mësimore ngrihen në përputhje me nevojat e njësisë bazë, me fushat dhe programet e studimit që ofron njësia bazë, me fushat e kërkimit dhe projektet e kërkimit të njësisë bazë ose të dy a më shumë njësisive bazë si dhe duke mbajtur parasysh numrin e anëtarëve të njësisë ose të anëtarëve të të njëjtave fusha të dy ose më shumë njësisive bazë të FGJH.
5. Krijimi, riorganizimi ose mbyllja e grupeve mësimore-kërkimore dhe grupeve kërkimore-mësimore të njësisë bazë bëhet me urdhër të dekanit të FGJH, bazuar në miratimin nga dekanati të propozimit të njësisë bazë.
6. Krijimi, riorganizimi ose mbyllja e grupeve mësimore-kërkimore dhe grupeve kërkimore-mësimore si bashkëpunim midis dy ose më shumë njësisive bazë bëhet me urdhër të dekanit të FGJH, bazuar në miratimin nga dekanati të propozimit të njërit prej njësisive bazë, mbështetur me miratimin e njësisive të tjera bashkëpunuese.
7. Krijimi, riorganizimi ose mbyllja e grupeve mësimore-kërkimore dhe grupeve kërkimore-mësimore bëhet në përfundim të vitit akademik.
8. Grupet mësimore-kërkimore dhe grupet kërkimore-mësimore përbëhen nga jo më pak se 5 personel akademik me kohë të plotë, ku të paktën njëri të jetë me titull akademik.
9. Statusi, struktura dhe mandati kohor i grupeve mësimore-kërkimore dhe grupeve kërkimore-mësimore përcaktohen nga dekanati i FGJH.



Neni 6

Përgjegjësi të grupit mësimor-kërkimor

1. Grupi mësimor-kërkimor mbulon disa lëndë mësimore të afërta me njëra-tjetrën dhe fushat përkatëse të kërkimit.
2. Grupi mësimor-kërkimor është përgjegjës për grup-lëndët përkatëse që ofrohen në programet e studimit që ofron njësia bazë pjesë e së cilës është.
3. Grupi mësimor-kërkimor përgjigjet për zhvillimin e disiplinave të grup-lëndëve që mbulon.
4. Grupi mësimor-kërkimor përgjigjet për hartimin dhe përditësimin e programeve mësimore të grup-lëndëve që mbulon, kujdeset për përditësimin e tyre dhe për respektimin e udhëzimeve për formatin e dokumentit të programit mësimor të lëndës.
5. Grupi mësimor-kërkimor përgjigjet për zhvillimin e metodologjisë së mësimdhënies për gruplëndët që zhvillon.
6. Grupi mësimor-kërkimor është përgjegjës për mbështetjen e të nxënit të studentëve në gruplëndët që zhvillon.
7. Grupi mësimor-kërkimor është përgjegjës për përzgjedhjen dhe miratimin e teksteve universitare dhe literaturës që përdoret në grup-lëndët që mbulon.
8. Grupi mësimor-kërkimor është përgjegjës për zhvillimin e kërkimeve në fushat e grup-lëndëve mësimore që mbulon.
9. Grupi mësimor-kërkimor përgjigjet për lidhjen e mësimimit me kërkimin.
10. Grupi mësimor-kërkimor është përgjegjës për zhvillimin profesional të anëtarëve të vet.
11. Grupi kërkimor-mësimor miraton planin e veprimtarisë së tij vjetore.
12. Grupi mësimor-kërkimor mblidhet si rregull një herë në dy muaj për të diskutuar çështje akademike të përgjegjësisë së tij, sipas një plani të miratuar në fillim të viti akademik.
13. Grupi mësimor-kërkimor zhvillon veprimtari të tilla, si: takime për çështje akademike dhe kërkimore, ndërmerr projekte për zhvillimin e kurrikulave lëndore, ndërmerr projekte për kërkimin në grup-lëndët që mbulon, ndërmerr veprimtari të zhvillimit profesional, si: ditë të zhvillimit profesional për mësimdhënien, të nxënit, kërkimit, kryen trajnime për të tretë në fushat që mbulon.
14. Grupi mësimor-kërkimor bashkëpunon me grupe analoge të universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit.
15. Grupi mësimor-kërkimor kryen vizita studimore në universitete ose institucione të tjera brenda ose jashtë vendit për të shkëmbyer përvoja dhe mirëpret kolëgë nga universitete të tjera nga brenda dhe jashtë vendit në kuadrin e bashkëpunimeve dypalëshe ose shumëpalëshe.
16. Grupi mësimor-kërkimor bëhet pjesë e rrjeteve dhe shoqatave profesionale. Anëtarësimi dhe ndjekja e veprimtarive mund të jetë individuale ose në grup.
17. Grupi mësimor-kërkimor mbështet botimet në fushat që mbulon.



18. Grupi mësimitor-kërkimor promovon veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të anëtarëve të vet.
19. Grupi mësimitor-kërkimor përmbush standardet e cilësisë për veprimtarinë që mbulon, sipas Kodit të cilësisë.
20. Grupi mësimitor-kërkimor përgatit raportin vjetor të veprimtarisë të cilin ia paraqet njësisë bazë pjesë e të cilit është dhe drejtuesit të njësisë bazë.

Neni 7

Përgjegjësi të grupit kërkimor-mësimitor

1. Grupi kërkimor-mësimitor mbulon disa fusha kërkimi të afërta me njëra-tjetrën.
2. Grupi kërkimor-mësimitor është përgjegjës për zhvillimin e kërkimeve në fushat që mbulon.
3. Anëtarët e grupit kërkimor-mësimitor kanë angazhim mësimitor të reduktuar në përputhje me aktet nëligjore.
4. Grupi kërkimor-mësimitor përgjigjet për zhvillimin e metodologjisë së kërkimit në lëndët mësimore përkatëse të programeve të studimit që ofron njësi bazë pjesë e të cilës është.
5. Grupi kërkimor-mësimitor është përgjegjës për zhvillimin e aftësive kërkimore të studentëve.
6. Grupi kërkimor-mësimitor përgjigjet për lidhjen e kërkimit me mësimin.
7. Grupi kërkimor-mësimitor është përgjegjës për zhvillimin profesional të anëtarëve të vet.
8. Grupi kërkimor-mësimitor miraton planin e veprimtarisë së tij vjetore.
9. Grupi kërkimor-mësimitor përcakton fushat e kërkimit për çdo vit dhe projekter e kërkimit.
10. Grupi kërkimor-mësimitor mblidhet si rregull një herë në dy muaj për të diskutuar çështje kërkimore dhe akademike të përgjegjësisë së tij, sipas një plani të miratuar në fillim të vitit akademik.
11. Grupi kërkimor-mësimitor zhvillon veprimtari të tilla, si: takime për çështje të kërkimit dhe akademike, ndërmerr projekte kërkimi për fushat që mbulon, ndërmerr veprimtari të zhvillimit profesional, si: ditë të zhvillimit profesional për kërkimin, të nxëniet, mësimitdhënien, kryen trajnime për të tretë në fushat që mbulon.
12. Grupi kërkimor-mësimitor bashkëpunon me grupe analoge të universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit.
13. Grupi kërkimor-mësimitor kryen vizita studimore në universitete ose institucione të tjera brenda ose jashtë vendit për të shkëmbyer përvoja dhe mirëpret kolëgë nga universitete të tjera nga brenda dhe jashtë vendit në kuadrin e bashkëpunimeve dypalëshe ose shumëpalëshe.
14. Grupi kërkimor-mësimitor bëhet pjesë e rrjeteve dhe shoqatave profesionale. Anëtarësimi dhe ndjekja e veprimtarive mund të jetë individuale ose në grup.
15. Grupi kërkimor-mësimitor mbështet botimet në fushat që mbulon.
16. Grupi kërkimor-mësimitor promovon veprimtarinë kërkimore të anëtarëve të vet.
17. Grupi kërkimor-mësimitor përmbush standardet e cilësisë për veprimtarinë që mbulon, sipas Kodit të cilësisë.
18. Grupi kërkimor-mësimitor përgatit raportin vjetor të veprimtarisë të cilin ia paraqet njësisë bazë dhe drejtuesit të njësisë bazë.



Neni 8

Ngarkesa mësimore dhe pagesa

1. Ngarkesa mësimore e anëtarëve të grupeve mësimore-kërkimore dhe grupeve kërkimoremësimore përcaktohet në përputhje me Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 i MASR “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.
2. Ngarkesa mësimore e drejtuesit të grupit mësimor-kërkimor është e njëjtë me atë drejtuesit të njësisë bazë, 90 orë mësimore.
3. Ngarkesa mësimore e drejtuesit të grupit kërkimor-mësimor përcaktohet nga dekanati i FGJH në përputhje Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 i MASR “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.
4. Pagesa e drejtuesit të grupit mësimor-kërkimor dhe grupit kërkimor-mësimor kryhet sipas përcaktimit në VKM nr.243, datë 20.04.2023, lidhja 1, pika 9,10.
- 5.

Neni 9

Caktimi në detyrë i drejtuesit të grupit mësimor-kërkimor dhe grupit kërkimor-mësimor

1. Caktimi në detyrë i drejtuesit të grupit mësimor-kërkimor dhe grupit kërkimor-mësimor bëhet në përputhje me Udhëzuesin për procedurën e përzgjedhjes së drejtuesve të grupeve mësimore-kërkimore dhe kërkimore-mësimore, miratuar nga dekanati i FGJH.
2. Kandidati për drejtues i grupit mësimor-kërkimor dhe grupit kërkimor-mësimor vetëkandidohet.
3. Përzgjedhja e drejtuesit të grupit mësimor-kërkimor dhe grupit kërkimor-mësimor bëhet në bazë të procedurës së konkurrimit, nga kandidatët e vetëkandiduar.
4. Për përzgjedhjen e drejtuesit të grupit mësimor-kërkimor dhe grupit kërkimor-mësimor mbahen parasysh këto kritere:
 - a. Respektohet hierarkia akademike, përzgjidhet kandidati me titullin akademik më të lartë.
 - b. Mbahet parasysh përvoja akademike, përzgjidhet kandidati me përvojë më të gjatë akademike.
 - c. Mbahet parasysh veprimtaria kërkimore, përzgjidhet kandidati me përvojën më të pasur dhe të spikatur kërkimore.
 - d. Mbahet parasysh kontributi në zhvillimin insitucional, përzgjidhet kandidati me përvojë në zhvillimin insitucional të universitetit, njësisë kryesore, njësisë bazë.
5. Mandati i drejtuesit të grupit mësimor-kërkimor dhe kërkimor-mësimor zgjat 4 vjet me të drejtë ricaktimi në detyrë edhe për një mandat të dytë. Mandati i tij përfundon: a) me mbarimin e afatit;
 - b) me dorëheqje;
 - c) kur ndërpret marrëdhëniet e punës me UT-në;



- ç) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; dh) në rastet e pamundësisë për të kryer detyrën; e) në rastet e shkeljeve të rënda të ligjit;
- ë) kur mbush moshën e pensionit.

Rregullime të tjera përcaktohen në akte të tjera nënligjore të UT-së dhe FGJH.

Neni 10

Përgjegjësi të drejtuesit të grupit mësimitor-kërkimor dhe kërkimor-mësimitor

Drejtuesi i grupit mësimitor-kërkimor dhe kërkimor-mësimitor ushtron këto funksione:

- a. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së grupit mësimitor-kërkimor ose kërkimor-mësimitor dhe përmbushjen e detyrave të kësaj strukture.
- b. Përgjigjet për realizimit e planit të veprimtarisë së grupit mësimitor-kërkimor ose kërkimormësimitor që drejton.
- c. Paraqet në njësinë bazë kërkesa për përmbushjen e nevojave akademike, kërkimore dhe zhvilluese të grupit që drejton.
- d. Përgatit buxhetin për veprimtarinë e grupit që drejton.
- e. Bën vlerësim për cilësinë e veprimtarisë së anëtarëve të grupit që drejton.
- f. Përgatit raporte dhe informacione për veprimtarinë e grupit që drejton.
- g. Përgjigjet për përmbushjen e standardeve të cilësisë të veprimtarisë që mbulon grupi që drejton, sipas Kodit të cilësisë
- h. Drejtuesi i grupit mësimitor-kërkimor dhe kërkimor-mësimitor në ushtrim të funksioneve të tij, shprehet sipas rastit me vendime, urdhra dhe udhëzime.

Neni 11

Marrëdhëniet e grupit mësimitor-kërkimor dhe kërkimor-mësimitor me njësinë bazë

1. Grupi mësimitor-kërkimor dhe kërkimor-mësimitor funksionon si strukturë zhvilluese brenda njësisë bazë ose si strukturë bashkëpunimi i dy a më shumë njësive bazë.
2. Grupi mësimitor-kërkimor dhe kërkimor-mësimitor nuk ka statusin e njësisë bazë dhe nuk ka funksionet e njësisë bazë.
3. Grupi mësimitor-kërkimor dhe kërkimor-mësimitor e zhvillon veprimtarinë e vet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të njësisë bazë dhe të FGJH dhe ka përgjegjësitë e veta për përmbushjen e misionit të FGJH.
4. Anëtarët e grupit mësimitor-kërkimor dhe kërkimor-mësimitor përmbushin të gjitha detyrimet që kanë si anëtarë të njësisë bazë, që lidhen me ngarkesën mësimore, zhvillimin e mësimit, praktikat profesionale, me vlerësimin e studentëve, me udhëheqjen e diplomave, me pranimin dhe transferimin e studentëve, me zhvillimin në karrierë, me bashkëpunimin me të tjerë dhe



aspekte të tjera të parashikuara në statutin e UT-së, Rregulloren e UT-së, Rregulloren e FGJH dhe Rregulloren e njësisë bazë.

5. Grupi mësitor-kërkimor dhe kërkimor mësitor përgatit buxhetin vjetor për mbulimin e veprimtarisë së tij dhe ia paraqet drejtuesit të njësisë bazë ose dekanit të FGJH në rastin e grupit ndërdepartamental.
6. Grupi mësitor-kërkimor dhe kërkimor-mësitor aplikon për projekte për ngritje kapacitetesh, zhvillim kurrikulash, për kërkim, për trajnim.
7. Grupi mësitor-kërkimor dhe kërkimor-mësitor raporton për përmbushjen e standardeve të cilësisë, sipas Kodit të cilësisë.
8. Grupi mësitor-kërkimor dhe kërkimor-mësitor i raporton veprimtarinë e vet njësisë bazë dhe drejtuesit të njësisë bazë ose dekanit në rastin e grupit ndërdepartamental.

KREU III DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 12

1. Kjo rregullore shqyrtohet në mënyrë periodike nga dekanati i FGJH dhe përditësohet ose ndryshohet.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga dekanati i FGJH.

